

2. Desha
27. Shtetërore Nr. 1507/2013



FAF
Nr. 1866 Pro/2013
Tiranë, më 15/07/2013

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
MINISTRI

11065/1

V E N D I M

Nr. 7, Datë 12.07.2013

PER

MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TE SHOQERISE "SHOQERIA E PARE
FINANCIARE E ZHVILLIMIT (FAF) SHA", PER VITIN 2012 DHE PER DESTINIMIN
E FITIMIT

Në mbështetje të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 127, pika 1, neni 135, pika 2. shkronjat dh) dhe e), dhe neni 177, me propozimin e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë, Ministri i Financave, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit (FAF)" sha,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë "Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit (FAF)" sha, për vitin 2012, të përgatitura nga shoqëria dhe të audituara nga audituesi i pavarur Deloitte Albania, me totalit e aktivitetit të pasivitetit për shumat 2.627.464.619 lekë (Dymiliardegjashtëqintënjëzeteshtatëmilionkatërqintëgjashtëdhjetekatërmijëgjashtëqintëmbëdhjetë), si formatet bashkëlidhur.
2. Të miratojë raportin e veprimtarisë së shoqërisë për vitin 2012, bashkëlidhur.
3. Të miratojë destinimin e fitimit neto të vitit 2012, në shumën prej 44.505.602 (Dyzetekatërmilione pesëqintë pesë mijë gjashtëqintë) lekë, si më poshtë:
 - 1.405.602 lekë, për shtim të rezervës ligjore.
 - 43.100.000 lekë, për zmadhim të kapitalit.
4. Zmadhimi i kapitalit të bëhet, duke shtuar numrin e aksioneve me 431 aksione, me vlerë nominale 100.000 lekë për çdo aksion.
5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi dhe për ta paraqitur atë pranë çdo autoriteti shtetëror të interesuar, sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ridvan BODE

MINISTER

Në mungesë dhe me porosi

Alfred RUSHAJ

ZV. MINISTER





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE

MINISTRI

17495/
Nr. _____ Prot. /

Tiranë, më 19/12/2014

VENDIM
I
AKSIONARIT TË VETËM

Nr. 12, datë 19.12.2014

“PËR
MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE DHE RAPORTIT TË AKTIVITETIT
PËR VITIN 2013 TË SHOQËRISË
“SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT – FAF” SH.A
DHE PËR DESTINIMIN E FITIMIT”

Në mbështetje të nenit 135 pika 2 gërmat “dh”, “e” dhe “ë” dhe pika 4, nenit 177 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neneve 8, 13, 37, 38 dhe 39 të Statutit të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a dhe me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, Ministri i Financave, në cilësinë e Aksionerit të Vetëm,

VENDOSI:

1. Të miratojë pasqyrat financiare të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a për periudhën 1 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013, të përgatitura nga shoqëria dhe të audituara nga audituesi i pavarur “Deloitte Audit Albania” sh.p.k, me totalet e aktivitetit dhe pasivitetit për shumat 2,705,342,346 (dy miliard e shtatë qind e pesë milion e tre qind e dyzet e dy mijë e treqind e dyzet e gjashtë), të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Të miratojë raportin e veprimtarisë së Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a për vitin 2013, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Të miratojë destinimin e fitimit neto për vitin 2013 në shumën 48,143,360 (dyzet e tetë milion e njëqind e dyzet e tremijë e treqind e gjashtë dhjetë) lekë si më poshtë:
 - 4,343,360 (katër milion e treqind e dyzetë e tremijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë për shtim të rezervës ligjore;
 - 43,800,000 (dyzet e tre milion e tetëqind mijë) lekë për zmadhim të kapitalit.
4. Zmadhimi i kapitalit të bëhet duke shtuar numrin e aksioneve me 438 aksione me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) lekë për çdo aksion.

Apl. Kantë
Aleksi Starmos

5. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi dhe për ta paraqitur atë pranë çdo autoriteti shtetëror të interesuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SHKËLQIM CANI



*Applikanti
Marko Stojanović*





REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI

Nr. 15026 /
Prot. 1

Tiranë, më 11/1/2016

VENDIM
I
AKSIONARIT TË VETËM

Nr. 39, datë 1/1/2016



“PËR
MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE DHE RAPORTIT TË AKTIVITETIT
PËR VITIN 2015 TË SHOQËRISË
“SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT” – FAF SH.A
DHE PËR DESTINIMIN E FITIMIT

Në mbështetje të nenit 135 pika 2 germat “dh”, “e”, “ë” dhe pika 4, neni 127 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008. “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) dhe nenet 8, 13, 23, 24, 38 dhe 39 të Statutit të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a dhe me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, Ministri i Financave, në cilësinë e Aksionarit të Vetëm,

VENDOSI

1. Të miratojë pasqyrat financiare të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a për periudhën 1 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2015, të përgatitura nga Shoqëria dhe të auditura nga audituesi i pavarur “Deloitte Audit Albania” sh.p.k, me totalit të aktivitetit dhe pasivitetit për shumat **2,987,164,287** (dy miliard e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Të miratojë raportin e veprimtarisë së Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a., për vitin 2015 i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Të miratojë destinimin e fitimit neto për vitin ushtrimor 2015 në shumën **29,086,141** (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë si më poshtë:
 - **86,141** (tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e një) lekë për shtim të rezervës ligjore;
 - **9,000,000** (nëntë milion) lekë për zmadhim të kapitalit.
 - **20,000,000** (njëzet milion) lekë për investime.

Zmadhimi i kapitalit të bëhet duke shtuar numrin e aksioneve me 90 aksione me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) lekë për çdo aksion.

5. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi dhe për ta paraqitur atë pranë çdo autoriteti shtetëror të interesuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ





REPUBLIKA E SHOQËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

8443/
08/08/2017

Nr. 1172 / Prot.

Tiranë, më 7.8.2017



MINISTRI
VENDIM
I
AKSIONARIT TË VETËM

Nr. 19, datë 7.8.2017

“PËR
MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE DHE RAPORTIT TË AKTIVITETIT
PËR VITIN 2016 TË SHOQËRISË
”SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT – FAF.SHA”
DHE PËR DESTINIMIN E FITIMIT

Në mbështetje të nenit 135, pika 2 gërmat “dh”, “e”, “ë” dhe nenit 127 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) dhe nenet 8, 13, 23, 4, 38, 39 të Statutit të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” Sh.a dhe me propozimin e Këshilli Mbikëqyrës të Shoqërisë, Ministri Financave, në cilësinë e Aksionarit të Vetëm,

VENDOSI

1. Të miratojë raportin e auditit të pavarur “Grant Thornton”, për pasqyrat financiare të Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF” sh.a për periudhën 1 Janar 2016 - 31 Dhjetor 2016, me totalet e aktivitetit dhe pasivitetit për shumat 2,983,218,431 (dy miliard e nëntëqind e tetëdhjetë e tre milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Të miratojë raportin e veprimtarisë së Shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF.sh.a”, për vitin 2016 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Të miratojë destinimin e fitimit neto për vitin ushtrimor 2016 në shumën 3,209,586 (tre milion e dyqind e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë si më poshtë:
 - 209,586 lekë (dyqind e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë për shtim të rezervës ligjore;
 - 3.000.000 (tre milion) lekë për zmadhim të kapitalit.
4. Zmadhimi i kapitalit të bëhet duke shtuar numrin e aksioneve me 30 aksione me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) lekë për çdo aksion.
5. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF" sh.a, për zbatimin e këtij vendimi dhe për ta paraqitur atë pranë çdo autoriteti shtetëror të interesuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**MINISTËR I FINANCEVE
AKSIONAR I VETËM I FAF.sha**


Helga Vukaj

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR**

Erjon Luçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE



Nr. 2088 / prot.
2

Tiranë, më 18 / 4 / 2019

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 15 / 1, datë 18 / 4 / 2019

PËR

MIRATIMIN E VENDIMIT NR. 21, DATË 26.12.2018 “ PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT DHE LOGOS SË SHOQËRISË “ SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT- FAF” SHA

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Vendimit Nr. 570, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “FAF” sha Tiranë, pasi shqyrtova vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës;

VENDOSA

1. Miratimin e Vendimit Nr. 21, datë 26.12.2018 të Këshillit Mbikëqyrës “ Për miratimin e ndryshimit të emrit dhe logos së shoqërisë “ Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit-FAF”sha Tiranë.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “ FAF” sha Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT FAF SH.A

KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM


Nr 21 datë 26/12/2018


PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT DHE LOGOS SË SHOQËRISË
“SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT – FAF SH.A.”


Në zbatim të nenit 154, dhe nenit 167 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), në mbështetje të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Shoqërisë së Parë Financiare të Zhvillimit FAF sh.a, Këshilli Mbikqyrës


VENDOSI:


1. Miratimin e ndryshimit të emrit të Shoqërisë nga “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF” sh.a, në “Agrokredit.sha”.
2. Miratimin e ndryshimit të Logos së shoqërisë, duke miratuar logon e re bashkëngjitur këtij vendimi.(Aneksi 1).
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Z.Elton Haxhi
Kryetar


Znj. Besa Sháhini
Anëtar


Z.Parid Shkurti
Anëtar


Z. Petro Koci
Anëtar


Z.Valbona Shujaku
Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE



Nr. 6998 Prot.

Tiranë, më 18.4.2019

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 24 Datë 18 / 4 /2019

PËR

EMËRIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 570, datë 03.10.2018 “ Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit” sha Tiranë;


VENDOSA

1. Emërimin në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në “Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit” sha Tiranë.

- Znj. Saida Turabi
2. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 , i ndryshuar“ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 3745 Prot.

Tiranë, më 18.4.2019

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 26 Datë 18.4.2019

PËR

**ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “SHOQËRIA E PARË FINANCIARE
E ZHVILLIMIT” FAF SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 116, datë 18.9.2018 “Për miratimin e vendimit Nr.11, datë 31.8.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “ FAF ” Për miratimin e pasqyrave financiare, raportit të aktivitetit për vitin 2017 dhe destinimin e fitimit”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “FAF” sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 47,800,000 lekë, i barabartë me 47,800 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 1,192,600,000 lekë, i barabartë me 1,192,600 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ngarkohet Drejtoria e shoqërisë “FAF” sh.a Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë



MINISTËR

Anila Denaj